



Komuna e Campi Bisenzio

Njoftim i përgjithshëm për konkurs për dhënie të banesave publike E.r.p.
(Edilizia residenziale pubblica) Shtëpi Popullore. Viti 2018

Përmbajtja

Duke aplikuar në këtë Njoftim ju mund të bëni pjesë në listën që formohet për dhënien e shtëpive publike E.r.p. (Edilizia residenziale pubblica) ose siç njihen ndryshe “shtëpi popullore” .

Mund të marrin pjesë në këtë Njoftim:

- Aplikantë të rinj;
- Pjestarët e familjes që janë në shtëpi popullore E.r.p., dhe kërkojnë ndarje familjare për nevoja autonome, si në rastet në vijim: çiftet e martuara, çifte *more uxurio* që bashkëjetojnë dhe rezultojnë të regjistruar në gjendje civile, persona të vetëm me fëmijë në ngarkim dhe persona të ndarë me gjyq të cilët kanë humbur të drejtën për strehim në shtëpinë bashkëshortore.

Duhet të paraqesin një kërkesë të re ata që janë fitues të shtëpisë popullore dhe që janë në një situatë mbipopullimi dhe ky ndryshim i njësisë familjare është vërtetuar pas caktimit të saj për arsye të tjera si: martesë ose bashkëjetesa *more uxorio*, lindjeje, adoptim apo dhënie në besim para-adoptimit.

Kushtet:

Mund të aplikojnë në këtë Njoftim të gjithë ata/o që:

- kanë **nënshtetësinë** italiane ose të një nga shtetet e Bashkimit Evropian;
- në rastin e qytetarëve të huaj, duhet të jenë me “leje qëndrimi pa afat U.E” (“permesso di soggiorno U.E. per soggiornanti di lungo periodo”); ose “leje qëndrimi” të paktën dyvjeçare (“permesso di soggiorno” almeno biennale) dhe që punojnë në rregull si punëtor ose si të vetëpunësuar; ose kush ka “leje qëndrimi / leje qëndrimi pa limit (carta di soggiorno / carta di soggiorno permanente) si familjarë i shtetasit të Bashkimit Evropian por më nënshtetësi jo B.E” ;
- kanë **vendbanim** të regjistruar në gjendjen civile (residenza anagrafe) **ose** **aktivitetin e punës** të përhershëm ekskluzivisht apo kryesor në **Toskana** të paktën prej **pesë vitesh**;
- kanë: **rezidencën** të regjistruar në **Komunën e Campi Bisenzio**; ose, në rast

se rezidenca është në një Komunë tjetër, por **aktiviteti i punës** është në **Komunën e Campi Bisenzio-s**: ose italianë të regjistruar si rezident jashtë Italisë në A.I.R.E (Anagrafe italiana residenti all'estero) të Komunës së Campi Bisenzio-s;

- kanë një gjëndje ekonomike familjare jo më të lartë se çertifikata **I.S.E.E** prej **16.500,00** euro (gjashtëmbëdhjetëmijë e pesëqind/00);
- **nuk janë pronarë** - asnjë nga pjesëtarët e familjes - i/e të **drejtave të pronësisë**, gëzues të ushfruktit, përdorues dhe banorë në ndërtesa që janë për banim të ndodhura në Itali apo jashtë saj;
- janë pronar pronësie të ndodhur në Itali apo jashtë saj, të caktuar gjatë ndarjes nga bashkëshorti/ja në gjyq, ose nëse jeni pronar i të drejtave reale me kuota mbi banesën, dhe keni çertifikatën ku vërtetohet **pamundësia** për strehim në atë banesë;
- **nuk janë pronarë** të regjistruar - asnjë nga pjesëtarët e familjes - të ndonjë **pasurie të luajtshme** me vlerë të përgjithshme jo më të lartë se **25.000,00** euro (njëzetepesë mijë/00), përveç rasteve të dokumentuara ku përdorimi i këtyre të mirave është i nevojshëm për të vazhduar punën;
- **nuk kanë patur pronësi të caktuara më parë**, ose me pakt për shitje të ardhshme, banesa të ndërtuara me fonde publike apo me kredi lehtësuese të dhëna për blerje në çfarëdo lloj forme nga Shteti, nga Qarku, nga autoritete lokale ose nga autoritete të tjera publike, duke përjashtuar rastet kur banesa është e papërdorshme apo e humbur dhe që nuk ka shkaktuar dëmshpërblim;
- **nuk kanë qënë marrës të ndonjë deklaratë për shfuqizim apo për humbje të së drejtës** për shtëpi popullore E.r.p sipas rasteve të parashikuara nga neni 35, paragrafi 2, shkronjat b), c), d), dhe e) e L.r.T n. 96/1996, duke përjashtuar rastin kur pagesa me vonesë të borxhit është i përfunduar para aplikimit të ri;
- **nuk kanë zënë** apo të kenë pushtuar **padrejtësisht** ose **pa autorizim** shtëpi popullore E.r.p., në pesë vitet para aplikimit të ri.

Të gjitha këto **kushte** të lartpërmendura (përveç rezidencës/ aktivitetit të punës në Komunën e Campi Bisenzio-s dhe për rezidencën/ aktivitetin e punës në Toskana në pesë vitet e fundit) duhet ti kenë **të gjithë pjesëtarët e familjes** të personit që aplikon në këtë njoftim.

Mënyra për të aplikuar

Të gjithë të interesuarit duhet të aplikojnë vetëm nëpërmjet **MËNYRËS ON LINE** duke përdorur platformën **"FIDO"** brënda afatit të detyrueshëm dhe jo më tej të orës **23,59** të datës **14 maj 2018**.

Ku mund të drejtoheni

Njoftojmë se pranë Sportelit Polifunksional (Sportello Polifunzionale / Pallati Komunal piazza Dante 37) ndodhet i pozicionuar një kompjuter për të përdorur platformën **"FIDO"** i vënë në dispozicion për ata persona që nuk kanë një PC

personal. Vini re, aty ndodhet vetëm kompjuter dhe **nuk** është e mundur që të skanerizohen dokumenta, prandaj çdo gjë duhet të jetë e skanerizuar para dhe e ruajtur në një 'pen' Usb ose çdo sistem tjetër ruajtës Usb. Gjithashtu ju kujtojmë se aty **nuk** ofrohet asnjë lloj ndihme për plotësimin e aplikimit.

- Kush nuk ka aftësitë e nevojshme për të përdorur platformën “FIDO”, mund të kontaktojë Zyrën e Shtëpisë (Ufficio Casa) (duke telefonuar vetëm në numrin **055/8959611**) për të caktuar një **takim** dhe një operator do tju ndihmojë në plotësimin e aplikimit.
- Për të përdorur këtë platformë është e domosdoshme që qytetari/ja të paraqitet me **kartën e tij/saj shëndetësore të aktivizuar** dhe me **kodin përkatës pin** ose me kredencialet **S. p. i. d.** (Sistemi Publik i Identitetit Dixhital) ose me **C.N.S.** (Karta Kombëtare e Shërbimeve).
- Gjithashtu është e nevojshme, të keni me vete çertifikatën I.S.E.E. të vlefshme, një dokument identiteti dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm (shih artikullin tjetër “Dokumentat që duhen të paraqiten” dhe tekstin e Njoftimit), duke përfshirë edhe një pullë prej 16.00 €.

Qytetarët italianë të regjistruar në A.I.R.E. të Komunës së Campi Bisenzio, nëse nuk kanë mundësi që të aplikojnë në platformën “FIDO”, duhet të kërkojnë formularin e aplikimit në letër duke shkruar një email te kjo adresë: serv.soc@comune.campi-bisenzio.fi.it ose duke dërguar një email pec në: comune.campi-bisenzio@postacert.toscana.it bashkëngjitur kopje të dokumentit të identitetit.

Komuna e Campi Bisenzio-s do të dërgojë formularin vetëm pasi të ketë kontrolluar regjistrimin në A.I.R.E. Të interesuarit do të kenë kohë për të dorëzuar aplikimin e tyre deri më datë **12/06/2018** ose përmes adresës së lartpërmendur p.e.c. ose duke dërguar një letër rekomande tek adresa: Comune di Campi Bisenzio, Ufficio Servizi Sociali e Casa, piazza Dante n. 36, 50013, Campi Bisenzio (FI), duke shkruar mbi zarf fjalët “Richiesta partecipazione Bando E.r.p.2018 – Iscritti A.I.R.E”. Në çdo rast kërkesa e të regjistruarve në A.I.R.E. duhet të dërgohet brenda orës 23.59 të datës 12/06/2018 (data e vulës postare nuk është e vlefshme).

Dokumentat që duhet të paraqiten

Të gjitha kushtet mund të jenë të vetëdeklaruar me përjashtim të disave që janë të specifikuar më poshtë, të cilat duhet t'i bashkëngjiten aplikimit:

- leje qëndrimi (dhe vërtetimin e punës në rastet e parashikuara) për qytetarët të cilët nuk janë të Bashimit Evropian;
- çertifikatë ku vërtetohet mungesa e pasurive jashtë vendit për të gjithë shtetasit ndryshe nga Italia; **ose** për pronarët e pronave jashtë vendit, dëshmi për pamundësi strehimi të caktuar gjatë ndarjes gjyqësore të bashkëshortëve ose e të drejtës reale me kuota.

Ndryshe nga leja e qëndrimit, e cila **domosdoshmërisht** duhet t'i bashkëngjitet aplikimit, deklaratat/ dëshmitë e sipërpërmendura mbi pronat e patundshme jashtë vendit mund të transmetohen më pas, por gjithnjë brenda afatit të prerë të orës 23,59 të datës **12/09/2018**.

Shpenzimet

Për të aplikuar në këtë njoftim nuk ka shpenzime të tjera, përveç pullës prej 16.00 ¤.

Si formohet lista e aplikuesve

Komuna, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga afati i njoftimit për aplikim, vazhdon me miratimin e listës së përkohshme sipas rendit të pikëve që i jepet secilit aplikim.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga publikimi i listës së përkohshme të lartpërmendur në Regjistrin online, (Albo pretorio online) të interesuarit mund të paraqesin kundërshtimet e tyre në Komisionin Komunal për formimin e listave E.r.p. dhe kërkesën për spostimet midis përfituesve të shtëpive komunale të Komunës së Campi Bisenzio.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga publikimi i listës së përkohshme, personi përgjegjës i procedurës i përcjell këtë listë Komisionit komunal të lartpërmendur, së bashku me kundërshtimet e paraqitura; Komisioni, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kundërshtimeve, vendos mbi to dhe formulon listën përfundimtare.

Në rast se ka shumë aplikantë me të njëjtin rezultat, renditja e listës vendoset në bazë të rritjes përparuese të gjendjes ekonomike të të ardhurave të regjistruara në përputhje me ligjin (d.m.th sa më pak e favorshme të jetë gjendja ekonomike më e lartë do të jetë renditja).

Pas publikimit të listës përfundimtare, do të jepen shtëpitë sipas renditjes të pikëve por duke marrë parasysh edhe madhësinë e banesave; deri atëherë shtëpitë do të jepen sipas renditjes në listën e Njoftimit të vitit të mëparshëm.

Mos harroni të...

- keni kartën shëndetësore të aktivizuar me kodin pin ose identitetin dixhital S.p.i.d. ose kartën tjetër C.n.s.;
- keni certifikatën I.S.E.E. të vlefshme;
- aplikoni jo më vonë se ora 23,59 e datës 14/05/2018.

Kujtesë

Ju kujtojmë që ky është një Njoftim i përgjithshëm, në të cilën **duhet të aplikojnë** edhe ata të interesuar të cilët janë të përfshirë në listën e

Njoftimit E.r.p. i vitit 2016, sepse ky i fundit nuk do të jëtë më i vlefshëm pas publikimit të listës përfundimtare të këtij Njoftimi të ri.

Ata/o që, në certifikatën e gjëndjes civile, kanë të shkruar **në zërin stato civile** “omesso” (“celibe”, “nubile”, “coniugato” e via dicendo) domethënë pa tregues, (me fjalët “beqar”, “beqare”, “i/e martuar” e kështu me radhë), duhet të paraqesin një kërkesë për përditësim jo më vonë se afati i prerë i datës **14/05/2018** pranë zyrës së gjëndjes civile (stato civile) të Komunës ku banon.

Ligjet ku bazohet ky Njoftim

- L.r.T. n. 96/1969 dhe formulimi i tij pasardhëse në L.r.T n. 41/2015;
- Rregullorja për dhënien dhe përdorimin e banesave popullore të E.r.p. në pronësi të Komunave të L.o.d.e fiorentine, e miratuar nga Konferenca e L.o.d.e fiorentine më datë 21/09/2015 dhe nga Komuna e Campi Bisenzio me vendim të Këshillit Komunal nr. 225 të 29/12/2015.